



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 38, datë 01/07/2004

**“PËR
RIKONSTRUKSIONIN E FUSHËS SË FUTBOLLIT TË STADIUMIT
“SELMAN STËRMASI”**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 01/07/2004, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” neni 32, gërma “dh”, ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 “Për buxhetin lokal”, neni 5, ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998,

V E N D O S I;

1. Të miratojë shtesën e fondit limit të investimeve për vitin 2004 në shumën **14.023.498** lekë për financimin e punimeve për “Rikonstruksionin e fushës së futbollit të Stadiumit “Selman Stërmasi”.
2. Efektet financiare në shumën **14.023.498** lekë, do të përballohen duke pakësuar fondin rezervë nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për vitin 2004.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI